

VENDIM
Nr. 30, datë 10.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 10.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 30 (B) 2025 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: Bedrie Pana (Ruci), përfaqësuar nga avokatët Adriatik Sallahu dhe Bashkim Rusi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1235, datë 9.4.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuës Bedrie Pana (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 27.11.2018 kërkuësja bashkë me vajzën e saj A.R. i janë drejtuar gjykatës me një padi, me objekt pjesëtimin e disa pasurive të paluajtshme, konkretisht të një apartamenti me sipërfaqe 20 m² dhe dy parcelave të llojit “tokë-arë”, me sipërfaqe 1080 m² dhe 1071 m², duke paditur për këtë bashkëpronarët e tjerë, shtetasit I.R. dhe I.R., respektivisht ish-bashkëshorti dhe djali i kërkuës. Në përfundim të fazës së parë të pjesëtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 276, datë 29.10.2019, ka vendosur lejimin e pjesëtimit, duke përcaktuar rrethin e bashkëpjesëtarëve, sendet që do të pjesëtohen, si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është paraqitur ankim.

2. Në fazën e dytë të pjesëtimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor, me vendimin nr. (11-2020-5670), datë 27.11.2020, ka vendosur pjesëtimin e pasurive në këtë mënyrë: i. apartamenti i është lënë në pronësi kërkuës përkundrejt kompensimit të bashkëpronarëve të tjerë, ish-bashkëshortit dhe djalit, për pjesët e tyre takuese, secili në vlerën 100.000 lekë; ii. parcela e tokës arë me sipërfaqe 1080 m² i është lënë në bashkëpronësi kërkuës dhe vajzës përkundrejt kompensimit të bashkëpronarit tjetër, ish-bashkëshortit të kërkuës, për pjesën e tij takuese në vlerën 287.733,33 lekë; iii. parcela tjetër e tokës arë me sipërfaqe 1071 m² i është lënë në pronësi ish-bashkëshortit të kërkuës përkundrejt kompensimit të kërkuës dhe vajzës për pjesët e tyre takuese, secila në vlerën 285.600 lekë. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim

nga i padituri I.R. (ish-bashkëshorti i kërkuases) dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës me nr. 21376-00590-10-2021, në datën 10.5.2021.

3. Çështja nuk është gjykuar deri në datën 1.2.2023, kur gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë riorganizuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Pas riorganizimit gjyqësor, në datën 3.2.2023, çështja e kërkuases është regjistruar tashmë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Në datën 4.12.2024, në rrethanat kur për shqyrtimin e çështjes nuk ishte kryer asnjë veprim gjyqësor, kërkuësja, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka paraqitur një kërkesë përpara Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës për shqyrtimin e çështjes. Kërkesa e kërkuases, bashkë me informacionin e gjyqtarit relator të çështjes, i është përcjellë Gjykatës së Lartë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e saj, ku është regjistruar në datën 28.2.2025.

5. Për kërkesën e kërkuases Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1235, datë 9.4.2025, ka vendosur rrëzimin e saj, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se mosveprimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësimin dhe qëndrimin abuziv të gjyqtarit relator, por për shkak të pamundësisë objektive të asaj gjykate si rezultat i ngarkesës së madhe nga akumulimi ndër vite i dosjeve dhe shkurtimit të numrit të gjyqtarëve në sistem, një problematikë e përgjithshme kjo, që tejkalonte rastin konkret dhe që është shkaktuar nga reforma në drejtësi, e cila ka sjellë natyrshëm edhe kosto për qytetarët në formën e tejzgjatjes së afateve të gjykimit të çështjeve gjyqësore.

6. Në datën 10.9.2025 (*data e shërbimit postar*), kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit, e cila, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.9.2025. Në datën 30.10.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës (sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) dhe deri më sot, në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kanë kaluar 4 vjet e 4 muaj dhe ende nuk ka një datë për shqyrtimin e çështjes, në kundërshtim me nenin 399/2 të KPC-së. Gjykata e Lartë, në mënyrë arbitrare, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, duke mos marrë parasysh, për më tepër, faktin se i padituri, ish-bashkëshorti i saj I.R., i cili ka paraqitur edhe ankimin, ka ndërruar jetë, fakt për të cilin ka depozituar edhe certifikatën e vdekjes. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 45-ditor për shqyrtimin e kërkesës, sipas nenit 399/7 të KPC-së. Në këtë mënyrë, me vendimin e saj, Gjykata e Lartë i ka mohuar edhe të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim sipas neneve 399/3 dhe 399/6 të KPC-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik

ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Gjykata vlerëson se kërkesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Po kështu, kërkesja ka *shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion*, pasi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjyimit nga gjykata e apelit, ndaj i vetmi mjet në dispozicion është ankimi kushtetues individual.

11. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, ndonëse mban datën 9.4.2025, i është komunikuar avokatit të saj nëpërmjet postës elektronike në datën 1.8.2025, ndërkohë që kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 10.9.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

12. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesja pretendon cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

13. Kërkesja ka pretenduar se nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës (sot Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm) dhe deri më sot, në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual kanë kaluar 4 vjet e 4 muaj dhe ende nuk ka një datë për shqyrtimin e çështjes, në kundërshtim me nenin 399/2 të KPC-së. Sipas saj, Gjykata e Lartë, në mënyrë arbitrare, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, duke mos marrë parasysh, për më tepër, faktin se i padituri, ish-bashkëshorti i saj I.R., i cili ka paraqitur edhe ankimin, ka ndërruar jetë, fakt për të cilin ka depozituar edhe certifikatën e tij të vdekjes. Po kështu, vijon ajo, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 45-ditor për shqyrtimin e kërkesës, sipas nenit 399/7 të KPC-së. Në këtë mënyrë, shprehet kërkesja, me vendimin e saj Gjykata e Lartë i ka mohuar edhe të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim sipas neneve 399/3 dhe 399/6 të KPC-së.

14. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjyimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjyimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje, në datën 27.11.2018, me padinë e paraqitur edhe nga kërkesja, nëpërmjet së cilës ka kërkuar pjesëtimin e pasurisë, të një apartamenti dhe dy parcelave tokë arë, ndërmjet saj dhe vajzës, nga njëra anë, si dhe ish-bashkëshortit dhe djalit të tyre, nga ana tjetër. Në gjykatën e shkallës së parë faza e parë e gjyimit të pjesëtimit ka përfunduar në datën 29.10.2019 dhe, në kushtet e mosparaqitjes së ankimit ndaj vendimit të kësaj faze, gjykimi ka vijuar në fazën e dytë të pjesëtimit, e cila ka përfunduar në datën 27.11.2020, pra 2 vjet pas paraqitjes së padisë. Më pas, mbi ankimin e një

prej palëve ndërgjyqëse, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 10.5.2021. Pas më shumë se 3 vjetësh e 7 muajsh nga regjistrimi i çështjes në gjykatën e apelit, ndonëse kërkesja ka kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 9.4.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Aktualisht, deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, kohëzgjatja e procesit gjyqësor vijon prej më shumë se 7 vjetësh e 2 muajsh, ndërsa vetëm në gjykatën e apelit çështja ka mbetur në pritje për t'u shqyrtuar përreth 4 vjet e 10 muaj.

16. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin ligjor 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së). Nisur nga kjo, formalisht, gjykimi i çështjes së kërkuës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

17. Për pasojë, është rasti që ky tejkallim i afatit të gjykimit të çështjes të vlerësohet në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për tejzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit, të cilat konsistojnë në: i. sjelljen e kërkuësit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësi (*shih vendimet nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuësit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë që të justifikojë një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuësj*, në rastin konkret, për shkak të vonësive në gjykimin e çështjes së saj.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” duhet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuësit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në konsideratë të kësaj jurisprudence, Gjykata vëren se në rastin konkret mosmarrëveshja, për të cilën edhe kërkuësj ka vënë lëvizje gjykatën e juridiksionit të zakonshëm, ka të bëjë me pjesëtimin e pasurisë ndërmjet saj, dy fëmijëve dhe ish-bashkëshortit, i cili rezulton të ketë ndërruar jetë (në datën 25.11.2022). Pra, në thelb, mosmarrëveshja lidhet me të drejtën e pronës, si dhe me përdorimin e saj, e cila, në kontekst të rastit konkret, ndërsa ka të bëjë me një apartament dhe dy sipërfaqe tokë arë, duke pasur në konsideratë edhe moshën e kërkuëses (rreth 72 vjeçe), për nga natyra e saj, mund të kualifikohet se ka të bëjë me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë* që, si rregull, kërkojnë trajtim me përparësi. Fakti që ish-bashkëshorti i kërkuëses, me të cilin ajo ka qenë në mosmarrëveshje për përdorimin e pasurive në bashkëpronësi, tashmë ka ndërruar jetë, nuk mund të zbehë interesin aktual të kërkuëses për përfundimin e shpejtë të procesit gjyqësor, i cili aktualisht duket se konsiston në qartësimin dhe konfirmimin e situatës së saj pasurore. Në këto kushte, Gjykata, në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuësj nga vonesa në gjykim, çmon se evidentohet rreziku për interesin e saj, natyra dhe rëndësia e të cilit justifikon trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

21. Për më tepër, referuar qëndrimin të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një

proces brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Gjithashtu, ajo ka theksuar se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak. Faktorë të tillë, të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të aftë, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih vendimin nr. 54, datë 9.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor tashmë vijon prej më shumë se 7 vjetësh e 2 muajsh, ndërsa vetëm në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm çështja është në pritje të shqyrtohet përreth 4 vjet e 10 muaj, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuësës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vendimi nr. 00-2025-1235, datë 9.4.2025, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuësës duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

23. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuësës duhet të pranohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1235, datë 9.4.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile nr. 21376-00590-10-2021, datë 10.5.2021, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.3.2026.

Shpallur më 30.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska, Asim Vokshi